

L I G J
Nr.7827, datë 31.5. 1994

PËR AVOKATINË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Avokatia në Republikën e Shqipërisë ushtrohet si profesion i lirë dhe i pavarur. Ajo ka për detyrë t’u japë ndihmë juridike pa asnjë dallim personave fizikë e juridikë shqiptarë e të huaj.

Neni 2

Ndihma juridike jepet:

- a) me këshillime për çështje ligjore;
- b) me përgatitje të kërkesëpadive ose të kërkesave për ndjekje penale;
- c) me përgatitje të kërkesave ankimore kundër vendimeve gjyqësore, të prokurorisë, të arbitrazhit e të organeve të administratës shtetërore;
- ç) me përgatitje të ankesave e kërkesave të personave juridikë e fizikë;
- d) me përpilimin e akteve që vërtetohen nga noteri;
- dh) me hartimin e kontratave dhe marrëveshjeve, si dhe të çdo dokumenti tjetër që sjell ose synon të sjellë pasoja juridike;
- e) me pjesëmarrjen si mbrojtës gjatë ndalimit të personit dhe në hetimin e gjykimin e çështjeve penale;
- ë) me përfaqësimin e pjesëmarrësve në gjykimin e çështjeve civile e administrative, në arbitrazh dhe në organe të tjera shtetërore për çështje administrative;
- f) në raste të tjera të parashikuara në ligj.

Neni 3

Avokati e ushtron profesionin e tij si individ dhe si zyrë avokatore.

Neni 4

Avokati nuk mund të krijojë më shumë se një zyrë avokatie.

Ai, si rregull, e ushtron veprimtarinë në territorin e juridiksionit të dhomës së avokatëve, në të cilën bën pjesë dhe ndodhet zyra e tij.

Avokati mund të ushtrojë veprimtarinë e tij edhe jashtë shtetit, në përputhje me ligjet e çdo vendi.

Neni 5

Avokati nuk mund të jetë në të njëjtën kohë noter, të ushtrojë veprimtari tregtare në emër të tij ose në emër të tjerëve, të jetë përfaqësues i çdo lloji kulturi fetare, si dhe të ushtrojë veprimtari

nëpunësie mbi bazën e marrëdhënieve të punës me shtetin, me përjashtim të veprimtarisë shkencore, artistike, letrare, arsimore e sportive.

KREU II TË DREJTAT DHE DETYRAT E AVOKATIT

Neni 6

Avokati, me cilësinë si përfaqësues ose mbrojtës, ka të drejtë të kërkojë nga organet shtetërore ose personat juridikë njoftime e dokumente, të cilat kanë të bëjnë me çështjen a me personin që përkatësisht përfaqëson ose mbron. Organet shtetërore dhe personat e tjerë juridikë janë të detyruar të plotësojnë kërkesat e avokatit.

Neni 7

Avokati ka të drejtë të takohet vetëm për vetëm dhe pa asnjë kufizim me klientin e tij të ndaluar, të arrestuar ose të burgosur. Takimet mund të bëhen në kushtet e shikimit nga organet kompetente, por në asnjë rast në kushte dëgjimi.

Organet kompetente detyrohen të sigurojnë menjëherë praninë e avokatit kur kërkohet nga një person i ndaluar, i arrestuar ose i burgosur dhe kryesisht kur ky person është i mitur, ose përfiton nga mbrojtja falas. Në çdo rast prania e avokatit duhet të sigurohet jo më vonë se njëzetekatër orë nga koha e ndalimit ose e arrestimit.

Neni 8

Avokati ka të drejtë, në pajtim me rregullat e zhvillimit të hetimit, të marrë pjesë në kryerjen e veprimeve hetimore, t'i drejtojë pyetje të pandehurit e dëshmitarëve, si dhe të njihet me gjithë materialin e çështjes në përfundim të hetimeve. Ai ka të drejtë të bëjë vërejtje në procesverbalet e veprimeve hetimore ku ka marrë pjesë, dhe t'i nënshkruajë ato.

Neni 9

Avokatit i ndalohet të bëjë kallëzim në organet kompetente dhe nuk mund të pyetet si dëshmitar për rrethana që i ka mësuar gjatë ushtrimit të profesionit si avokat. Atij i ndalohet të përhapë të dhëna që i ka mësuar gjatë kryerjes së detyrës së tij për dhënien e ndihmës juridike.

Neni 10

Avokati ka të drejtë të heqë dorë nga përfaqësimi ose mbrojtja e filluar duke njoftuar 15 ditë përpara klientin e vet si dhe duke kthyer shpërblimin e marrë sipas marrëveshjes ndërmjet palëve.

Neni 11

Avokati mund të heqë dorë përkohësisht nga ushtrimi i këtij profesioni për kohën që do të jetë në marrëdhënie pune, ose që do të ushtrojë një veprimtari fitimprurëse. Për këtë qëllim ai njofton Dhomën e avokatëve ku bën pjesë. Kur ai zgjidhet deputet në Kuvendin Popullor ose kryetar bashkie, nuk pengohet të marrë pjesë në jetën publike të dhomës, por nuk mund ta ushtrojë profesionin si avokat.

Neni 12

Avokati ka për detyrë ta ushtrojë profesionin e tij me nder e dinjitet. Ai duhet të respektojë rregullat e etikës profesionale dhe të përdorë të gjitha mjetet e ligjshme për mbrojtjen me besnikëri të të drejtave dhe interesave të personave fizikë a juridikë që mbron ose përfaqëson.

Neni 13

Avokati përpara se të fillojë veprimtarinë e tij duhet të bëjë betimin sipas mënyrës dhe formulës së vendosur nga Dhoma Kombëtare e Avokatëve.

Neni 14

Avokati nuk mund të marrë përsipër çështjet kur me hetuesin, prokurorin ose gjyqtarin që gjykon çështjen, është gjini a krushqi e afërt. Gjithashtu nuk mund të marrë përsipër një çështje, në të cilën ka marrë pjesë si hetues, prokuror, gjyqtar, ekspert ose dëshmitar.

Avokatit i ndalohet t'i japë ndihmë juridike ose të përfaqësojë në gjyq njërën palë, kur më parë ai i ka dhënë ndihmë ose ka përfaqësuar palën tjetër në këtë çështje, ose ka ndonjë lidhje a interes me të.

Avokatët e së njëjtës zyrë avokatore nuk mund të përfaqësojnë në të njëjtën çështje palë kundërshtare.

KREU III ORGANIZIMI I PËRFAQËSIMIT PROFESIONAL TË AVOKATËVE

Neni 15

Përfaqësimi profesional i avokatëve organizohet në dhomat e avokatëve dhe në Dhomën Kombëtare të Avokatëve, të cilët janë persona juridikë.

Neni 16

Dhoma e avokatëve ngrihet në një ose në disa rrethe, sipas përcaktimit të bërë nga ministri i Drejtësisë, pasi ka marrë miratimin e Dhomës Kombëtare të Avokatëve, në bazë të numrit të popullsisë dhe vëllimit të punës në çdonjërin prej tyre.

Dhoma e avokatëve përbëhet nga avokatët që janë anëtarë të saj dhe kanë qëndrën e veprimtarisë së tyre në territorin ku ajo vepron.

Dhoma e avokatëve është organ territorial i avokatëve dhe e zhvillon veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur, në bazë të këtij ligji dhe të statutit të miratuar prej saj.

Organet drejtuese të dhomës së avokatëve janë:

Mbledhja e përgjithshme e avokatëve dhe këshilli drejtues i saj.

Neni 17

Mbledhja e përgjithshme e avokatëve ka edhe këto kompetenca:

1. Merr masa për përgatitjen e vazhdueshme profesionale të avokatëve.
2. Përfaqëson dhe mbron interesat e avokatëve anëtarë të saj dhe ndihmon për funksionimin normal të zyrove avokatore.
3. Shqyrton kërkesën për anëtarësi në dhomën e avokatëve dhe i jep mendimin e saj Dhomës Kombëtare të Avokatëve.
4. Miraton statutin e dhomës së avokatëve.

5. Vendos për masat disiplinore ndaj avokatëve e stazhierëve, në bazë të kërkesave për nisjen e procedimit disiplinor.

6. Vendos për kontributin periodik që duhet të derdhë secili pjesëtar i saj, si dhe për miratimin dhe administrimin e buxhetit të saj.

7. Cakton numrin e anëtarëve të këshillit drejtues dhe përbërjen e tij.

8. Cakton stazhierët pranë avokatëve të kësaj dhome.

9. Vendos për mbarimin e dhomës së avokatëve.

10. Zgjedh përfaqësuesin për në dhomën kombëtare të avokatëve.

Neni 18

Këshilli drejtues i dhomës së avokatëve ka edhe këto kompetenca:

- Thërret mbledhjen e përgjithshme të dhomës së avokatëve.

- Cakton zëvendësin e avokatit për çështjet që përfaqëson kur ai largohet nga dhoma e avokatëve dhe nuk ka marrë masa për të caktuar zëvendësin e tij, si dhe avokatin ose zyrën avokatore ku kërkohet kryesisht nga gjykata, në bazë të rregullave të miratuara për këtë qëllim.

- Harton projektbuxhetin e dhomës së avokatëve.

- Kryen detyra të tjera të ngarkuara nga mbledhja e përgjithshme ose të parashikuara në statut.

- Kërkon nisjen e procedimit disiplinor.

Neni 19

Dhoma Kombëtare e Avokatëve është organ gjithëvendor i avokatëve, vepron në mënyrë të pavarur dhe përbëhet nga përfaqësues të dhomave të avokatëve, jo më pak se një përfaqësues për çdo dhomë.

Organet drejtuese të saj janë: mbledhja e përgjithshme dhe këshilli drejtues.

Neni 20

Mbledhja e përgjithshme e Dhomës Kombëtare të Avokatëve ka edhe këto të drejta:

- Mbikëqyr veprimtarinë e dhomave të avokatëve në bazë të kompetencave të dhëna në këtë ligj në statutin e saj.

- Ndhmon e bashkërendon punën e dhomave të avokatëve për të siguruar vënien në jetë të të drejtave e të detyrimeve të ligjshme të avokatëve, përfaqëson dhe mbron interesat e tyre e të dhomave të avokatëve.

- Ndhmon dhomat e avokatëve për rritjen e kualifikimit profesional të avokatëve e të stazhierëve.

- Shqyrton ankimet kundër masave disiplinore të dhëna nga dhomat e avokatëve.

- Miraton statutin e saj.

- Zgjedh Këshillin drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatëve.

- Cakton kontributin financiar të dhomave të avokatisë, për të përballuar veprimtarinë e saj.

- Harton dhe miraton Kodin Etik të Avokatit.

Neni 21

Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatëve përbëhet nga jo më pak se pesë avokatë që zgjidhen nga Dhoma Kombëtare e Avokatëve.

Këshilli drejtues ka edhe këto kompetenca:

- Thërret mbledhjen e përgjithshme të Dhomës Kombëtare të Avokatëve, në rastet e

parashikuara nga ky ligj e në statutin e saj.

- Jep lejen për ushtrimin e avokatisë, kur plotësohen kushtet e parashikuara nga neni 24 i këtij ligji.

- Heq lejen për ushtrimin e këtij profesioni në rastet e parashikuara nga neni 32 i këtij ligji.

- Zbaton detyrat e ngarkuara nga Dhoma Kombëtare e Avokatëve.

Neni 22

Zyra avokatore ka për qëllim ushtrimin e veprimtarisë avokatore. Ajo përbëhet nga jo më pak se dy avokatë, që janë anëtarë të së njëjtës dhomë avokatore.

Zyra avokatore funksionon sipas statutit të saj, i cili duhet të miratohet nga dhoma përkatëse e avokatëve, brenda një muaji nga dita e paraqitjes së statutit. Kur kjo e fundit vëren se statuti bie në kundërshtim me dispozitat ligjore, brenda 15 ditëve, ia kthen zyrës avokatore për të bërë ndryshimet e nevojshme.

Neni 23

Ministri i Drejtësisë mbikëqyr ligjshmërinë në veprimtarinë e dhomave avokatore dhe të Dhomës Kombëtare të Avokatëve. Në zbatim të kësaj detyre, ministri i Drejtësisë kontrollon:

- a) Mbështetjen ligjore të rregulloreve organizative e funksionale të dhomës së avokatëve dhe të Dhomës Kombëtare të Avokatëve.

- b) Bazueshmërinë në ligj të vendimeve të dhomave të avokatëve dhe të Dhomës Kombëtare të Avokatëve.

- c) Pezullon vendimet ose rregulloret e sipërpërmendura, si dhe statutet e dhomave të avokatëve, të zyrave avokatore e të Dhomës Kombëtare të Avokatëve, kur bien në kundërshtim me dispozitat në fuqi.

KREU IV

KUSHTET PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË AVOKATIT

Neni 24

Personi që kërkon të ushtrojë profesionin e avokatit duhet të plotësojë këto kushte:

- a) të jetë shtetas shqiptar dhe me banim të përhershëm në Shqipëri;

- b) të ketë arsimin e lartë juridik;

- c) të ketë kryer stazhin prej jo më pak se një vit pranë një avokati ose zyrë avokatore;

- ç) të ketë dhënë provimin e kualifikimit;

- d) të ketë të drejtë morale që të mbrojë të drejtat e liritë personale të njeriut, si dhe të plotësojë kërkesat e etikës profesionale;

- dh) të mos jetë dënuar për vepra penale të kryera me dashje që parashikohen në Kodin Etik nga Dhoma Kombëtare e Avokatëve.

- e) të mos ushtrojë veprimtari ose të mos ketë detyrime financiare që nuk i përshtaten profesionit të një avokati;

- ë) të jetë anëtar i një dhome të avokatëve, në territorin e së cilës do të ketë zyrën.

Me kërkesën e tij dhe me miratimin e dhomave përkatëse të avokatisë, mund të kalojë në një dhomë tjetër.

Neni 25

Provimi i kualifikimit jepet përpara një komisioni të caktuar nga ministri i Drejtësisë.

Riprovimi lejohet vetëm pasi të jetë kryer një stazh tjetër prej jo më pak se 6 muajsh.
Rregullat për funksionimin e komisionit, lëndët profesionale dhe mënyra e dhënies së provimit caktohen nga ministri i Drejtësisë.
Në këtë komision merr pjesë edhe një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Neni 26

Përgjashtimi nga detyrimi për dhënien e provimit të kualifikimit mund të bëhet me urdhër të ministrit të Drejtësisë, duke u mbështetur në vjetërsinë në punë si jurist, në aftësitë profesionale të treguara dhe në shkallën e arsimimit për kualifikimin profesional.

Neni 27

Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë pajis me leje për ushtrimin e profesionit të avokatit pedagogët efektivë të lëndëve juridike në Fakultetin e Drejtësisë, për raste të veçanta dhe sipas kriterëve të përcaktuara në statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatëve.

Me leje të tillë pajisen edhe juristët me grada e tituj shkencorë, që nuk kryejnë detyra shtetërore me pagë të përhershme.

Neni 28

Avokati i nënshtrohet provimit të kualifikimit çdo 5 vjet.

Ministri i Drejtësisë mbikqyr zbatimin e rregullave për dhënien e provimit të kualifikimit dhe anulon atë kur vëren shkelje të rregullave përkatëse.

Neni 29

Përgjashtohen nga kryerja e stazhit juristët që kanë punuar më parë mbi dy vjet si gjyqtarë, prokurorë, deputetë ose këshilltarë ligjorë në personat juridikë publikë ose privatë, pedagogët e lëndëve juridike në Fakultetin e Drejtësisë dhe juristët që kanë grada e tituj shkencorë në fushën e drejtësisë.

Neni 30

Kërkesa për dhënien e lejes për ushtrimin e avokatisë shqyrtohet nga dhoma përkatëse e avokatëve brenda 1 muaji nga paraqitja e saj. Mendimi i dhomës, së bashku me aktet që i lidhen kërkesës, i dërgohen Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatëve jo më vonë se 5 ditë nga shqyrtimi i saj. Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare merr në shqyrtim dhe vendos jo më vonë se 20 ditë nga data e mbërritjes së akteve.

Neni 31

Heqja e lejes së avokatisë mund të kërkohet nga ministri i Drejtësisë dhe nga dhoma, në të cilën ka bërë pjesë avokati.

Vendimi i Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatëve, që jep ose refuzon dhënien e lejes së avokatisë ose e heq atë në kushtet e parashikuara prej nenit 32 të këtij ligji, mund të ankohet nga ministri i Drejtësisë dhe avokati i interesuar, brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes ose e njoftimit të vendimit në gjykatën e shkallës së dytë, në territorin e së cilës ushtron veprimtarinë avokati i interesuar.

Këshilli Drejtues, përpara se të vendosë, duhet të dëgjojë avokatin e interesuar.

Neni 32

Avokatit i hiqet leja nga Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatëve dhe çregjistrohet nga regjistri përkatës kur:

- a) leja është dhënë në kundërshtim me kushtet e parashikuara në nenin 24 të këtij ligji;
- b) leja është marrë me dokumente të falsifikuara, pas vërtetimit me vendim të formës së prerë të gjykatës;
- c) bëhet i paaftë për shkak sëmundjeje ose dëmtimi të shëndetit;

Neni 33

Avokatët e pajisur me lejen përkatëse nga Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatëve nuk mund ta fillojnë veprimtarinë e tyre, pa u regjistruar në regjistrin e avokatëve që ndodhet në Ministrinë e Drejtësisë.

Në këtë regjistrë shënohen emri dhe mbiemri i avokatit, data e marrjes së lejes për ushtrimin e profesionit, datëlindja e avokatit, viti i diplomimit të tij si jurist, rrethi ku ai ka filluar ushtrimin e profesionit të avokatit, masat disiplinore që mund të jenë marrë ndaj tij, gradat ose tituj shkencorë, gjuhët e huaja që njeh, si dhe shënimet e tjera plotësuese.

Neni 34

Avokati ka të drejtë të ketë asistentë.

Asistentët zgjidhen nga vetë avokati ndër personat e diplomuar juristë, por që nuk kanë stazhin e nevojshëm për të qenë avokatë ose që nuk kanë marrë ende lejen për ushtrimin e profesionit të avokatit dhe regjistrohen në regjistrin e asistentëve në Ministrinë e Drejtësisë.

Në regjistrin e asistentëve, shënohet emri dhe mbiemri i asistentit, data se kur është diplomuar jurist, data se kur e ka filluar stazhin, emri i avokatit ose i zyrës avokatore pranë të cilës kryen stazhin, si dhe shënime të tjera plotësuese.

Me autorizim me shkrim të avokatit dhe kurdohërë me pëlqimin e klientit, asistenti përfaqëson ose mbron të interesuarit në çështje të thjeshta në hetimin dhe gjykimin e shkallës së parë.

KREU V SHPËRBILIMI I PUNËS SË AVOKATIT

Neni 35

Avokati ka të drejtë të marrë shpërblim për ndihmën juridike që jep në rastet e parashikuara nga neni 2 i këtij ligji, si dhe shpenzimet që ka bërë për kryerjen e veprimeve avokatore.

Shpërblimi për ndihmën juridike jepet në bazë të tarifave të caktuara ose në marrëveshje me klientin e cila duhet të dokumentohet.

Personat juridikë e fizikë, shqiptarë ose të huaj, mund të lidhin kontratë edhe për shpërblim fiks të punës së avokatit sipas marrëveshjes ndërmjet tyre.

Neni 36

Në raste të veçanta të mbrojtjes së detyrueshme ose kur të interesuarit nuk janë në gjendje ekonomike për të siguruar mbrojtjen, me vendim të prokurorit ose të gjykatës, ndihma juridike jepet falas dhe shpenzimet përballohen nga fondi shtetëror i caktuar për këtë qëllim. Në të tilla raste shpërblimi i avokatit caktohet përkatësisht nga prokurori ose gjykata sipas tarifave.

Avokati i ngarkuar kryesisht duhet të njoftohet me shkrim nga organi përkatës. Njoftimi duhet të siglohet edhe nga vetë avokati.

Neni 37

Avokati është i detyruar të evidencojë në një libër të gjithë ndihmën juridike të dhënë, të shënojë në atë të gjitha aktet e hartuara sipas numrit rendor të tyre, emrin e tij ose të zyrës avokatore, si dhe shpërblimet e marra për ndihmën juridike të dhënë në të gjitha format dhe llojet e saj.

Shkelja e këtij rregulli sjell përgjegjësi disiplinore, dhe, kur është rasti, edhe përgjegjësi financiare, sipas dispozitave në fuqi.

Organi kompetent financiar ka të drejtën e kontrollit të dokumentacionit përkatës.

Neni 38

Avokatët dhe punonjësit e tjerë të avokatisë gëzojnë të drejtën e sigurimeve shoqërore sipas rregullave të caktuara me ligj.

KREU VI PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE

Neni 39

Avokati i nënshtrohet, sipas rastit, përgjegjësisë disiplinore administrative ose penale, kur vepron në kundërshtim me Kushtetutën, me ligjet dhe etikën profesionale.

Avokati që punon veçmas ose zyra avokatore, përgjigjen civilisht për dëmet që i shkaktohen klientit për fajin e tyre.

Neni 40

Avokati dhe asistenti kanë përgjegjësi disiplinore, kur:

- a) ushtrojnë veprimtarinë në kundërshtim me ligjin dhe etikën profesionale;
- b) nuk mbajnë në rregull librin e tarifave të zbatuara që marrin nga klientët ose nuk pasqyrojnë drejt në to shpërblimin e dhënë;
- c) nuk kujdesen për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe interesave të klientëve të tyre.

Neni 41

Për shkeljet në kryerjen e detyrës, ndaj avokatit ose asistentit merren këto masa disiplinore:

- a) vërejtje me shkrim;
- b) gjobë nga 5-50 mijë lekë;
- c) heqje e së drejtës të ushtrimit të profesionit nga 3 muaj deri në 5 vjet.

Në dhënien e masave disiplinore merret parasysh shkalla e fajësisë dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes. Në marrjen e masave disiplinore nuk është i detyrueshëm respektimi i rradhës, por kjo duhet t'i përgjigjet shkeljes së kryer.

Avokatët, ndaj të cilëve merret masa e parashikuar në shkronjën “c” të këtij neni, pas mbarimit të dëmit, detyrohen t'i nënshtrohen provimit në bazë të kriterëve të caktuara.

Neni 42

Për përgjegjësinë disiplinore të avokatit zbatohen këto rregulla:

Ndaj avokatëve kanë të drejtë të kërkojnë nisjen e procedimit disiplinor klientët, ministri i Drejtësisë, Këshilli Drejtues i Dhomës së Avokatëve, gjykata e prokuroria.

Kur kërkesa nga klienti i drejtohet zyrës avokatore, ndaj avokatit fajtor mund të merren masat disiplinore të parashikuara në statutin e saj.

Kërkesa për nisjen e procedimit disiplinor shqyrtohet nga Dhoma e Avokatëve, brenda 15 ditëve nga paraqitja e saj.

Kundër vendimit të dhënë nga Dhoma e Avokatëve mund të bëhet ankim nga avokati i dënuar, nga organi që ka kërkuar nisjen e procedimit disiplinor dhe ministri i Drejtësisë, brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes ose e njoftimit në Dhomën Kombëtare të Avokatëve. Kjo e fundit shqyrton ankesën jo më vonë se 15 ditë nga regjistrimi i saj.

Avokati, organi që ka kërkuar nisjen e procedimit disiplinor dhe ministri i Drejtësisë kanë të drejtë të kundërshtojnë vendimin e Dhomës Kombëtare të Avokatëve, brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes ose e njoftimit të saj, në gjykatën e shkallës së dytë.

Neni 43

Masat disiplinore ndaj avokatëve jepen jo më vonë se 1 vit nga dita e kryerjes së shkeljes. Dënimet disiplinore parashkruhen brenda 1 viti nga dita e përfundimit të vuajtjes.

Vendimet që përmbajnë masa disiplinore, i dërgohen për regjistrim Ministrisë së Drejtësisë.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 44

Ministria e Drejtësisë kujdeset që veprimtaria e avokatisë të ushtrohet normalisht dhe në përputhje me ligjet.

Për zbatimin e këtij ligji Ministri i Drejtësisë nxjerr rregullore përkatëse dhe, pasi merr mendimin e ministrit të Financave e të Dhomës Kombëtare të avokatëve, cakton tarifat e shpërblimit për dhënien e ndihmës juridike.

Neni 45

Çdo avokat, ose zyrë avokatore, ka vulën e tij në formën katërkëndëshi, ku shënohet titulli “avokat”, emri e mbiemri i avokatit, emri i zyrës avokatore dhe qendra administrative ku shtrihet veprimtaria.

Neni 46

Dhënia e lejes dhe ushtrimi i profesionit të avokatit i nënshtrohen taksës dhe tatimit të parashikuar në dispozita të veçanta.

Neni 47

Dispozitave të këtij ligji për provimin e kualifikimit dhe për detyrimet që parashikohen në nenin 46 i nënshtrohen dhe avokatët e pajisur me leje deri në ditën e hyrjes në fuqi të tij.

Neni 48

Ligji nr.7541, datë 18.12.1991 “Për Avokatinë në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizohet.

Neni 49

Ky ligj hyn në fuqi 15 pas botimit në Fletoren zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.862, datë 14.6.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.